



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 04**

**Datë: 12. 01. 2021. Ora: 15:00**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.**

**Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Artan Asllani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.**

**SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.**

**ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.**

**Përkthyes: Argjina Misini**

**Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

**RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
- 2. Aktivitetet e SKQZ-së**
- 3. Aktivitetet e ZRPPC-së**
- 4. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

**-Këshilli për Operacione Zgjedhore**

-Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për materialet ndjeshme për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës,

a)Për shtypjen e fletëvotimeve dhe broshurave,

b)Për shtypjen, kontrollimin, paketimin dhe transportimin e Listave Përfundimtare të Votuesve dhe Listave Komunale të Votuesve,

c)Për shtypjen e formave zgjedhore (formularë zgjedhore),

d)Për furnizim me UV sprej,

e)Për furnizim me vula dhe jastëk të vulave dhe

#### **-Këshilli për Çështje Ligjore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzuesit Administrativ Nr. 01/2021, për verifikimin e aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës

#### **-Këshilli për Buxhet dhe Financa**

- Shqyrtimi i planit të prokurimit për vitin 2021;

#### **5.Të ndryshme.**

---

### **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**

**Valdete Daka:** Përshëndetje të gjithëve. Së pari kërkujmë falje mediave sepse kemi dhënë një orar tjetër të mbledhjes po, për shkak të shqyrtimit të dokumenteve na është dashur pak ma shumë kohë. Gjithsesi unë e hapi mbledhjen e 4 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. A kemi ndonjë çështje që ka të bëjë me rendin e ditës? Unë e di që këshilli për buxhet dhe financa nu ka arrit, për shkak të stërzgjatjes së takimit të këshillit për çështje ligjore, nuk ka arrit ta shqyrtoj planin e prokurimit për vitin 2021 , po në diskutim me kryesuesin e këshillit dhe disa prej natarëve u pajtum që këtë pikë ta qesim drejpërsëdrejti në KQZ

pra, pa shqyrtim të këshillit, meqense kemi procedura urgjente dhe stafi është pa durim me prit këtë plan që të filloj procedurat e prokurimit, pa të cilat nuk mund ti organizojmë zgjedhjet, pra nëse pajtoheni me këtë rend dite, unë e kisha qitë në votim. Kush është për këtë rend dite?

Anëtarët e KQZ-së, miratojnë rendin e ditës

## **2. Aktivitetet e SKQZ-së**

**Burim Ahmetaj:** Faleminderit kryetar. Të nderuar anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Sekretariati sipas obligimeve të saj është në planin dhe në rrjedhën e zbatimit e planit operacional që ka të bëjë me përgatitjet e zgjedhjeve të parakohshme të kuvendit të Kosovës të cilat do të mbahen me 14 shkurt. Janë dy periudha të cilat do të fillojnë nga shërbimi I votuesve , dhe tri periudha tjera të cilat ndërlidhen me kordinimin në teren. Sa I përket periudhës së shërbimit votues, ju njoftoj se me datën 13 janar 2021 do të filloj pra, periudha e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës , dhe do të përfundoj me 21 janar në orën 18 të kohës lokale të Republikës së Kosovës. Sa I përket përgatitjeve për fillimin e kësaj përudhe sekretariati I Komisionit Qendror të Zgjedhjeve pra prej sodit ka filluar edhe për pozitimin e informative për këtë periudhë duke përfshirë edhe postimin e dokumenteve në ueb-faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Po ashtu edhe për pyetjet e parashturara të cilat më së shpeshti I kanë bërë votuesit apo qytetarët, të cilat I kanë adresuar në adresë të komisionit të zgjedhjeve dhe për të gjitha këto informata bazike të përgjithshme, ju ka dhënë përgjigje Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Po ashtu gjithashtu sot në uebfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do të postohen edhe formularët e aplikimit për regjistrim të votuesve, të cilat janë miratuar nga Komisioni Qendror I Zgjedhjeve sipas vendimit 41/2021. Divizioni I shërbimit votues nga sot do të filloj me dërgimin e aplikacioneve për regjistrim, për votuesit që në zgjedhjet e vitit 2019, dhe në zgjedhjet për kryetar komune në komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut, të cilat janë mbajtur me 29 nëntor 2019-të. Kishin arritur të përfshiheshin në listën e votuesve, jashtë Kosovës pra për të gjithë këto dy kategori do të dërgoj aplikacionet për regjistrim, për këta votues .Po ashtu sekretariati I Komisionit Qendror të zgjedhjeve në kuadër të përgatitjeve, të aktiviteteve, ka siguruar edhe hapësirën fizike ku do të kryhen këto shërbime. Falënderojmë edhe Ministrin e Punëve të Brendshme sidomos Divizionin e administratës dhe përkrahësin që na ka mundësuar hapësirë shtesë ku do të punojmë edhe me opracione. Ju njoftoj se divizioni I shërbimit votues përkatësisht, shërbimi i votuesve do të vendoset në objektin e Rilindjes në sallën 015 ku

është një sallë e mjaftueshme dhe i plotëson kriteret dhe kushtet për të operuar divizioni apo shërbimi votues ku edhe sot veq se ka filluar, periudha e votimit jashtë vendit.

Pra, tha më tej z. Ahmetaj, është ne katin përdhes në objektin e Rilindjes dhe do të punohet në dy ndërrime. Ndërsa departamentet tjera do të vendosen një pjesë, në hapësirat jashtë objektit të Rilindjes, që janë përkatësisht kontinjerat të cilat i shfrytëzon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Për shërbimet e tjera siç, janë një pjesë, të shërbimit të zyres së partive politike të kordinimit teren. Dhe pjesë tjetër të shërbimit votës. Ndërsa divizioni i trajnimit do të jetë i vendosur në objektin e Ministrisë së Infrastrukturës. Objektin të cilin në vitin 2019 e ka përdorur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për shërbimin votues. Pra kjo është pjesa e akomodimit, ku do të vendoset edhe stafi gjatë kësaj periudhe. Ndërsa më datën 14 janar 2021 do të filloj periudha e regjistrimit të votuesve me nevoja të veçanta, kryesisht kategoria e personave të palëvizshëm të cilët për shkak të paaftësive fizike, kjo periudhë do të filloj me datën 14 janar dhe do të përfundojë me 18 janar. Ndërsa sa i përket kordinimit terren janë edhe tri aktivitete, të cilat janë në zbatim e sipër në përputhje me planin operacional. Është fjala për propozimet e anëtareve të komisioneve komunale zgjedhore të cilët pritet të trajtohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga dita e nesërme e tutje. Pra ashtu është edhe formula e udhëzimit për mbi mënyrën e përzgjedhjes së personelit të stafit teknik. Dhe të qendrave të votimit dhe , po ashtu është në përgatitje lista apo masterlista e qendrave të votimit.

Të gjitha këto, besoj që shumë shpejtë do të trajtohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe të vazhdojmë me operacione tjera. Pra këto ishin informatat në lidhje me aktivitetet e sekretariatit të komisioni qendror të zgjedhjeve.

**Valdete Daka:** Faleminderit Burim. A ka dikush pyetje për Burimin? Nëse jo, vazhdojmë me aktivitetet e ZRPP-së.

### **3.Aktivitetet e ZRPPC-së**

**Yll Buleshka:** Faleminderit shumë e nderuar kryetare, te nderuar anëtare, media dhe kolegë nga shoqëria civile. Shumë shkurt, sot jemi në ditën e fundit të afatit për aplikim për kualicionet parazgjedhore. Deri më tani kemi pranuar aplikimin nga dy koalicionet parazgjedhore , një është aplikacioni Vakati i përbërë nga partitë politike DSB dhe DSV të cilat e përfaqësojnë komunitetin boshnjak të Kosovës, si dhe kemi koalicionin Zajno, i përbërë nga partitë politike PG dhe GIG të cilat e përfaqësojnë komunitetin goran të

Kosovës. Këto aplikacione janë dorëzuar deri në këto momente ndërsa afati I fundit për deri në orën 6-të. Përveç kësaj, kemi pranuar aplikimin e parë për certifikim si subjekt politik nga një iniciativë qytetare. Kemi të bëjmë më iniciativën Romania iniciativa nga komuniteti rome i Kosovës e cila udhëhiqet nga Gëzim Jahiroviq me qendër në Mitrovicë të Veriut. Jemi menjherë dmth, duke I shqyrtuar këto aplikacione dhe jemi në pritje të aplikacioneve të reja. Kjo është gjendja e tanishme, jemi duke e kompletuar stafin kështu që kemi kapacitet të mjaftueshëm për trajtim të aplikacioneve.

**Valdete Daka** : S'po besoj që kemi pyetje tash për tash. Vazhdojmë me raportin e këshillave të KQZ-së.

**Artan Asllani**: Faleminderit kryetare. Kisha pas lutje te ZRPP-ja me pas parasysh që është një numër I madh I partive politike që janë dukë kandiduar për certifikim , kështu që e kisha pas një lutje që me pas parasysh nënshkrimin, se është një numër I madh tu marr nënshkrime dhe me i verifikua nënshkrimet se po keqpërdoren nënshkrimet, dhe ka informata që nënshkrimet janë, se veç po i marrin numrat e letërnjoftimit dhe po bahen vet kështu që me pas një konsiderate, me pas një kontrolle ma të madh.

**Yll Buleshkaj**: Po, kemi pranuar edhe informata të tilla. Zyra, është me të gjitha kapacitetet që i ka duke u përpjekë ti trajtoje në mënyrë, me të mire të mundshme këto aplikacione. Është duke për herë të parë ndonjëherë duke bërë verifikimin e secilit person, I cili është nënshkruar ne listën, pikërisht për ta parë a është votues I listës së votuesve të Republikës së Kosovës. Së dyti është duke u bërë edhe krahasim sipas legjislacionit, nënshkrimet mos duken që janë nga dora e njëjtë. Përveç kësaj ne kemi vendos si zyre , që të bëjmë verifikimin e një numri të caktuar, të personave që janë përkrahës duke I kontaktuar me telefon që a janë përkrahës të atij subjekti politik. Sepse në mënyrë që ti largojmë të gjitha këto dyshime, në qoftëse dikush kontaktohet edhe thotë jo. Numrin ma kanë marrë, për diçka tjetër edhe këto atëherë, do ti kontaktojmë subjektet politike dhe do ti paraqesim të gjitha të gjetura. Do te thot duhet me pas kujdes të veçantë, sepse e dimë këto janë zgjedhjet për kuvendin e Kosovës ku merren vendime tepër te rëndësishme për shtetin tonë.

Gjithçka, do të verifikohet një nga një në mënyrë ma të mire të mundshme. Përveç kësaj në qofëse ka informata për diçka të tilla, mund të paraqiten edhe ankessa në institucione tjera për verifikim nga ekspertet sepse ne nuk kemi ekspertizë. Për ta verifikuar secilin nënshkrim se a është personi që e ka qit , por na e bëjmë një verifikim se a janë me nga dukun nga dora e njëjtë apo jo. Ndërsa ekspertizën e ka specializuar m'duket vetëm prokuria dhe policia e Kosovës.

**Sami Kurteshi:** A do të thotë kjo, se ju do ta bëni një ekspertizë grafologjike. E dyta rastet që konstatohen se janë keqpërdorimi sidomos të numrit personal. Si veprohet ma tutje me të?

**Yll Buleshkaj:** Në qoftë se hasim në raste të tilla dhe vërehet që është e qëllimshme ne me siguri kemi obligim edhe ligjor edhe kushtetues që këto raste ti paraqesim ne institucionet që ndajnë drejtësinë në Kosovë dhe institucionet ndjekse. Kështu që nëse verifikojmë diçka të tillë na do ti procedojmë në institucione tjera te prokuroria e shtetit ne qoftë se vec vërehet diçka e qëllimshme, ndërsa në I kemi edhe parasysh, s'mund të ndodhin edhe gabime gjatë marrjes se numrave, numër plus. Por në qoftë se e vërejmë që ka më shumë, është pak më e organizuar atëherë, me siguri që do ti ndjekim edhe rastet në institucione tjera.

**Valdete Daka:** Vazhdojmë me këshillin për operacione zgjedhore.

#### **4.Raport i Këshillave të KQZ-së**

##### **1.Këshilli për Operacione Zgjedhore**

Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për materialet ndjeshme për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës:

*a)Për shtypjen e fletëvotimeve dhe broshurave,*

*b)Për shtypjen, kontrollimin, paketimin dhe transportimin e Listave Përfundimtare të Votuesve dhe Listave Komunale të Votuesve,*

*c)Për shtypjen e formave zgjedhore (formularë zgjedhore),*

*d)Për furnizim me UV sprej,*

*e)Për furnizim me vula dhe jastëk të vulave*

**Alim Rama:** Faleminderit kryesuse. Në këshillin për operacione zgjedhore kemi bërë shqyrtimin dhe miratimin e specifikave teknike për materialet e ndjeshme për zgjedhjet e parakohshme për kuvendin e Kosovës. Vec deshta të ju rikujtojë që na si KQZ-së kemi aprovuar rregulloren për formatin e fletëvotimeve. Kështu që, ai rekomandimi është marr parasysh dhe specifikat teknike për fletëvotimet dhe broshurat, janë në përputhje me rregulloren. Vetëm këtu na ka mbete me definu numrin e fletëvotimeve të cilat sekretariati rekomandon që të jenë rreth 1.8 milion. Kështu që me qatë

rekomandim, në bazë të rekomandimit të sekretariatit ne po e rekomandojmë KQZ-në me aprovua këto specifika.

**Valdete Daka:** Kjo është shtypja për specifikat për shtypjen e fletëvotimeve dhe broshurave, ndërkaq sa I përket numri të fletëvotimeve të cilat do të shtypen ky është vendim I cili do të merret në ndërkohë. Varësisht nga lista votuese dhe rregullat tjera që I kemi. Pra tash votojmë për specifikat teknike për shtypjen e fletëvotimeve dhe broshurave. Kush është për? Pra këtu I kemi specifikat.

**Alim Rama:** Tash nën pikën b., kemi shtypjen dhe kontrollimin, paketimin dhe transportimin e listave përfundimtare të votuesve dhe listat komunale të votuesve. Keni specifika T para jush. Sekretariati rekomandon që të përshtypjen përafërsisht 2700 lista përfundimtare të votuesve si dhe 1200 lista komunale të votuesve. Specifikat i keni përpara. Specifikat janë bërë konform praktikave të mëparshme të KQZ-së. Edhe këshilli për operacione zgjedhore I ka aprovuar këto dhe i ka rekomandon KQZ-së për aprovim.

**Valdete Daka:** Atëherë, kush është për miratimin e specifikave teknike për shtypjen e formularëve për zgjedhjet e parakohshme. Kush është për? Faleminderit. Miratohen...

**Alim Rama:** Për shtypjen e reformave zgjedhore kjo pikë ka qenë për listën e votuesve. Formularët që kanë mu shtyp kanë me u shtyp me katër kopje karbon, si dhe një premtim e dhëna vetëm këto dhe u zvogluar numri i zarfeve të votave me kusht. Krahasim, me zgjedhjet e kalueshme. Në bazë të raportit të sekretariatit kanë mbet një numër i teprum i zarfave, të votave me kusht kështu që prej 500.000 mij qe kanë qenë praktik tash mundohen 200.000 përafërsisht.

**Valdete Daka:** Unë prap e kundërshtoj se asnjëherë në asnjë par zgjedhje na nuk kena pas ma shumë se 30.000 votues me kusht. I kemi 200.000 mijë zarfa të fletëvotimeve me kusht pastaj I kemi edhe 200.000 mijë zarfa tjera të fshehtësisë, që janë 400.000 mijë zarfa. Unë po ju thom me përgjegjësi të plotë asnjë palë zgjedhje që nga viti 2010 na ma shumë se 30.000 mijë votues me kusht nuk kena pas kurrë, kështu që nuk besoj që kemi me pas edhe në këto zgjedhje 200.000.

**Alim Rama:** Apet, sekretariati me dhanë shpjegim sepse kanë qenë rekomandim I qeverisë. Edhe na kemi kërku njëjtë si ju që të jetë numri sa më I vogël.

**Sami Hamiti:** Faleminderit kryetare. Kemi diskutuar gjatë në KOZ, çështjen e këtyrë zarfave. Është e vërtetë që duke e trajtuar stokin që është në depo dhe që e kemi pajtuar ma herët. Që ka me qindra mijëra që kanë mbetur nga zgjedhjet tjera. Ne, e shikim mundësinë, po mbishkrimet në ato zarfet nuk janë të përdorshme për këto zgjedhje. Nuk mund t'i përdorim ato që kanë mbetur. Ku UNMIKU shkruan mbi të edhe nuk mund të përdoret. Ka mbishkrim i cili për këto zgjedhje nuk mund të përdoret kështu që çështja është a do të jenë? Se unë sa e mora vesh 200.000 që është i ndamë, 100.000 mijë me 100.000 mijë zarfin e fshehtësisë dhe zarfin tjetër.

**Valdete Daka:** Këtu shkruan 200.000 mijë të fshehtësisë dhe 200.000 me kusht.

**Sami Hamiti:** Dmth ajo mund të zbritet, kërkesa e tyre. I mediave anëtarët të KOZ-it kanë qenë që ajo duhet të zvogëlohet në mundësitë që sekretariati kërkon.

**Alim Rama:** Edhe ne kemi kërkuar që të merret parasysh trendi i votave me kusht në ato vendvotime edhe sa mundemi me zëvendësua sekretariati.

**Valdete Daka:** Pse është kërkuar 200.000 mijë, përkundër asaj që na e dimë që 30.000 mijë votues me kusht i kena maksimalisht.

**Burim Ahmetaj:** Është e vërtetë që është një numër shumë i madh i zarfave të cilat nuk do të mund të përdoren për shkak të mbishkrimet që i potencun edhe anëtarët e tjerë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Mirëpo, kjo shifër 200.000 mijë nuk është shumë reale, mirëpo është shifër e përafërt sepse nuk është dërgojmë për pa rezerva. Zotri Rama e ceku që do të reflektojmë në bazë të trendit të votimit në dy parë zgjedhjet e fundit. Që nuk do ta dërgojmë numrin e njëjtë të zarfave nëpër secilin vendvotim apo nëpër secilin qendër po do ta dërgojmë varësisht sipas trendit të votuesve që kanë votuar me kusht. Duke pasur parasysh se trendi është më i madh në zgjedhjet për kuvendin e Kosovës për të votuar me kusht se sa në raport me zgjedhjet lokale. Kështu që në këtë aspekt edhe KOZ-i ka konsiderua se këto, me këtë ndryshim nuk do të mund të pësojmë me ndryshimet me të njëjtat do të mund të përdoren edhe për zgjedhjet lokale, kështu që të njëjtat çka mbesin në stok do mund të përdorim edhe në zgjedhjet lokale kështu që nuk do të hupin praktikisht këto zarfe edhe nëse i blejmë 200.000 mijë.



Mirëpo, kemi konsiderua që koncentrimin ma të madh sidomos votuesit me kusht, e kanë nëpër komuna apo nëpër qytete, ndërsa në zonat rurale shifet se trendi është ma e vogël i votuesve me kusht. Kështu që nuk mund të them që është shumë i vogël - as shumë i madh, shifra 200.000 mijë mirëpo, i plotëson kriteret sepse do të dërgojmë varësisht prej vlerësimeve, varësisht prej trendëve, kështu që pjesa që mbetet do ti përdorim për zgjedhjet lokale. Ky është edhe vlerësimi nga sekretariati. Faleminderit.

**Alim Rama:** Një kërkesë për administratën, tek numër 6 është fjala për fletën llogaritëse të formatin A3 duhet të jetë në dengjet 30 copa deri në 120.000 mijë apo? Ju lutem a ka një sqarim për të gjitha këto? Është fjala për 120.000mij dengje apo 120.000 mijë cop ?

**Burim Ahmetaj:** Janë fleta llogaritëse të kandidatëve të cilët do të shpërndahen për çdo vend votim në bazë të cilave do të përdoren dy fleta për të njëjtin subjekt që praktikisht është procedurë që për secilin subjekt ato fleta llogaritëse të plotësohen nga dy palë të ndryshme për shkak të saktësisë që kur te llogaritsh se sa subjekte politike garojnë, plus dy kështu që shifra është kalkulu dhe në bazë të kësaj kështu që uën mënoj që shifra edhe i plotëson kriteret që janë në llogari. Pra edhe një herw, janë subjektet që garojnë, numri i subjekteve dhe në bazë të procedurave duhet për shkak të saktësisë të plotësohen nga dy këshilla të vendvotimit të ndryshëm. Kështu që shifra është reale.

**Valdete Daka:** Mire, i kemi edhe këto shenjat të cilat prapë më duken numra të jashtëzakonshëm, p.sh shenja ndalohen armët, 9 mijë copë. Na i kemi 2400 vendvotime me sa e di unë. Edhe janë 9 mijë shenja. 9 mijë shenja ndalohet prija e duhanit, 9 mijë shenja e kahja e shigjetës a qa janë këto? dhe prapë zarfe 5 mijë. Prapë, i kemi zarfe 5 mijë me një vend , 5 mijë anën tjetër?

**Burim Ahmetaj:** Zarfet na shërbejnë për operacione të ndryshme, ndash shërbejnë për qendra të numërimit, ndash shërbejnë për divizionin të shërbimeve votuese kështu që azrfet janë të formatit A3 dhe A4 të cilat na shërbejnë për operacione të ndryshme.

**Arianit Elshani:** E kemi diskutu edhe në operacione zgjedhore këtë çështje edhe siç, e tha zoti Rama edhe z. Hamiti, realisht këna arrit edhe ka qenë vendim i sekretariatit që të ulet aj numër nga 500 mijë në 200 mijë. Kështu që si rekomandim e para e mirëpritur faktin që tha sekretariati, tjetra vendosëm meqenëse zarfet e para që janë ne KOD, janë zarfe të cilat nuk dallojnë nga zgjedhjet lokale, ndërsa zarfet e fshehtësisë dallojnë nga zgjedhjet në zgjedhje, me zgjedhjet lokale të kuvendit të përgjithshme për shkak

që është dallimi i ngjyrës, d.m.th., që ato janë me, lokalet janë me dy ngjyra të tjera dhe këto parlamentare janë me ngjyrë tjetër, kështu që kjo ka qenë në lidhje me çështjen e fshehtësisë. Që realisht herën e ardhshme për zgjedhjet lokale na bie vetëm zarfe të fshehtësisë t'porosisum, ndërsa zarfet të madhja d.m.th., këto nuk kemi nevojë ti porosisim sepse do të teprojnë por, në qoftëse mendoni tjetra çështje po. Nuk keni një analizë të qartë të qendrave të votimit në raport me numrin e popullsisë, në raport me numrin e votuesve realisht në ato qendra të votimit në të cilën do të bëheshin edhe klasifikimin që në mënyrë sa ma racionale të bëhet edhe porosia mirëpo, edhe në anën tjetër të bëhet edhe shpërndarja e saj. Sepse në ditën e zgjedhjeve, në situatën që jemi aktualisht, në një kohë kaq të përshpejtuar mund të ndodhë që me një vendvotim, me një qendër votimi të jenë më pak zarfe se sa realisht do të nevojiten. Sidoqoftë, prapë jam dakord që është numër i madh, por është përgjysmua në raport me secilën palë zgjedhje tjetër që është mbajta në Kosovë.

**Valdete Daka:** Pra sekretariati mbetet pro këtyre 200 mijave. Unë pra po e rezervoj të drejtën që kur të kryhen zgjedhjet me ditë sa zarfa janë harxhu. Edhe unë tash po deklaron që unë abstenoj nga votimi? Kush është për miratimin e specifikave teknike për shtypjen e formularëve zgjedhor dhe për zgjedhjet e parakohshme. Kush është për? Faleminderit. Unë abstenoj. Vazhdojmë pra me pikën tjetër.

**Alim Rama:** Po ashtu, kemi specifika dhe kërkesën për furnizimin me ujë dhe sprej. Diferenca prej zgjedhjeve të kaluara është që uji dhe spreji ka pasur jetëgjatësinë prej së paku dy vjet dhe nuk ndodhë që me sprej me tepru edhe me harxhu pa nevojë.

**Valdete Daka:** Sa ujë dhe sprej të porositum. 6mij? Kush është pro? Vazhdojmë me këshillin me çështje zgjedhore. A e kemi udhëzimin. Udhëzimin për aplikacione për regjistrim për votim jashtë Kosovës. Unë e di që dje kemi pas shqetësime të jashtëzakonshme, të cilat unë i kuptoj edhe nga shoqëria civile, edhe nga diaspora dhe nga qytetarët tonë, të cilët jetojnë jashtë, por unë edhe një herë e potencoj që KQZ-ja është institucion i pavarur i cili, i merr vendimet në mënyrë kolegjiale dhe ne si KQZ-ë në radhë të parë, e kemi integritetin në procese zgjedhore e pastaj vijnë interesat e subjekteve politike, interesat e gjithë të tjerëve por në radhë të parë është integriteti i çdo vote, pra qoftë pra ajo nga diaspora, qoftë nga qytetarët të cilët votojnë këtu në Kosovë. Duhet të jenë të vërteta dhe të sakta pra, duhet ta dijë se kush po e hudh votën ditën e zgjedhjeve.

Prandaj, tha z. Daka, vendim dje i cili është marrë, edhe pse shumë i kontestueshëm nga të gjitha anët, megjithatë, është vetëm në funksion të integritetit të gjitha operacioneve zgjedhore e sidomos të vendvotimit. Pra, na e dimë se votimi jashtë Kosovës është një proces shumë lehtë i manipulueshëm për faktin se ne vetëm për mjet të postës komunikojmë me votuesit të cilët janë jashtë Kosovës dhe kanë të drejtë të votojnë, prandaj edhe na nevojiten mekanizma të mbrojtjes për këtë votë. Dhe mekanizma të cilët e vërtetojnë se votuesit me të vërtet janë ata të cilët edhe kanë apliku për tu regjistrua për votim jashtë Kosovës. E kemi këtu një udhëzim administrativ i cili ka kalua në këshillin për çështje ligjore. Unë e kisha lutë edhe Arianitin që të na informojë ma hollësisht në lidhje me këtë udhëzim? I cili do të sqarojë dhe do të specifikojë mënyrën se si bëhet verifikimi i aplikacioneve. Dhe se e arsyeton edhe vendimin e djeshëm të cilin e kemi marr.

## **2.Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzuesit Administrativ Nr. 01/2021, për verifikimin e aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës:

**Arianit Elshani:** Faleminderit shumë kryetare. Sot, këshilli për çështje ligjore ka trajtuar draft udhëzimin administrativ për verifikimin e aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës, i cili ka ardhur si rezultat nga vendimi i djeshëm i cili është votuar nga të gjithë anëtarët unanimsisht. Përmes të cilit jemi të obliguar si këshill për çështje ligjore që të krijojmë në procedurë, një standardë, se si do të komunikohet dhe se si do të bimë në kontakt me aplikuesit për regjistrim të aplikuesve nga jashtë. Sigurisht që edhe aj vendim i djeshëm ka ardhur nga vullneti i të gjithë anëtareve për shkak të asaj se çka ka ndodhur në zgjedhjet e 2017-ës duke u referuar zgjedhjeve të Istogut dhe procedurave tjera të kaluara që kanë ndodh si keqpërdorime. Kjo asnjëherë, sigurisht që nuk ka ardh si vullnet që ti vështirësojë dikujt votimin e as apiikimin, por ka ardhur si vullnet që të ruaj votën e gjithsecilit, veçmas të diasporës e cila meriton realisht edhe vota e saj të trajtohet dhe të mos keqpërdoret as emri i tyre dhe as vota e tyre. Kështu që në këshill kemi ra pothuajse të gjithë dakord lidhur me përmbajtjen me nenet që janë brenda udhëzimit, përveç një pike me të cilën realisht, dy nga anëtarët nuk kanë votuar pro asaj pike.

Unw, tha z. Elshani, rekomandoj si kryesues i këshillit për çështje ligjore, meqenëse është aprovuar si udhëzim administrativ. Në këshill për çështje ligjore rekomandoj që te, miratohet propozimi i këshillit për çështje ligjore. Faleminderit...

**Valdete Daka:** Unë për me i evitu diskutimet e gjata, unë kisha rekomandu që ne ta shqyrtojmë nen për nen dhe aty ku pajtohem ta votojmë secili nen edhe në fund ta votojmë në tersi.

**Alim Rama:** Veç deshta pak se nga ka rrjedh kjo punë e këtij udhëzimit. Realisht, çështja u shtrua në këshill për operacione zgjedhore qysh e përmendi kolegu Arianiti, për rastin e Istogut. Edhe në këshill për çështje ligjore, kur s'kemi pas për qëllim që të verifikohen secili qytetar që thirret në telefon. Por që të evitohen të gjitha rastet e dyshimta. Në momentin që sekretariati e gjanë një rast të dyshimta që menjëherë të zhvillohen procedura edhe të hetohen. Unë vetëm e kisha marr rastin në zgjedhjet e kaluara, ku kemi mbi 40 mijë aplikacione, por i kemi 35 mijë aplikime të pranuar. Dhe s'ka qenë praktika që edhe ato të pranuarat të raportohen detalisht dhe a ka ba hetimet e mëtutjeshëm. Qëllimi i këtij udhëzimi d.m.th., që ka dalë është që në secilin në ato raste ku kemi refuzime të arsyetohet nga sekretariati pse janë refuzua, çfarë tentimi kanë ba, mi kontaktua ata persona dhe cila është arsyeja dhe në rastin e fundit në qoftë se shohim keqpërdorim ose raste të dyshimta ku behët, atëherë të informohet edhe prokuroria d.m.th., me shkua edhe n'i hap ma tutje që të formohet prokuroria. Në qoftë se ka pas raste ku, si në rastin e Istogut ka pas intenca për keqpërdorime në mënyrë të organizume.

**Valdete Daka:** Na para disa dite e kemi aprovu një formular të regjistrimit dhe aplikimit për votim jashtë Kosovës. Ky formular i cili ka ekzistua prej që ekziston votimi jashtë Kosovës. Pra ky formular nuk është ndryshua asnjëherë, tash është ndryshu dhe në vend të dy numrave të telefonit është kërkuar vetëm një numër, dmth personi i cili aplikon ta zgjedh numrin apo atë të shtëpisë numrin statik apo ta shënoj numrin mobil pra është përzgjedhja e personit i cili aplikon dhe natyrisht që të gjithë jemi pajtua që ky formular i regjistrimit si i tilël të del edhe në ëebfaqen tonë dhe nga nesër të filloj edhe aplikimi. Asnjëherë, nuk është tentu që KQZ-ja të ja pamundësoj qytetarëve të diasporës që të votojnë, përkundrazi KQZ-ja është duke u munduar në vazhdimësi të jau lehtësoj. Tash nuk është faji i KQZ-së, që ne kemi vazhdimisht zgjedhje të jashtëzakonshme dhe afatet për aplikim janë aq të shkurta, dhe aq të ngjeshura sa që një numër i madh i diasporës nuk arrin as të aplikoj e as të votoj. Pra tash në nuk mundemi me i zgjat afatet ligjore të cilat janë të përcaktume me ligj dhë të cilat na jemi të obligum ti aplikojmë dhe ti implementojmë. Çështja tjetër është që ne si KQZ-ë, në anën tjetër duhet patjetër të jemi të sigurt, që

cdo aplikues i cili voton është i vërtet dhe qëndron pranë atij aplikimi. Pra ne vetëm këtë dëshirojmë ta bëjmë dhe ne kemi obligim ligjor që ta dimë se kush voton dhe jo që ti pranojmë aplikimet të cilat qartazi shihen se janë të manipuluar dhe të keqpërdorura nga kushdo qofshin ata. Unë prapë kisha dashtë që të filloj , ku meqenëse këtu kemi pika të cilat nuk janë të koncentruar...

**Sami Hamiti:** Faleminderit kryetare. Ne, është e vërtet që ne e kemi debatuar në të dy këshillat. Unë jam në njerin këshill për operacione zgjedhore. Çështjen edhe të aplikacioneve, por edhe të integritetit të procesit zgjedhor. Në asnjë variant as njëri prej anëtareve nuk e ka qit në diskutim atë që duhet ta vështirësojnë çështjen e aplikimit përkundrazi, ta rrisin integritetin në proceset zgjedhore sepse, është një prej rekomandimeve të thjeshta të misionit vëzhgues të BE-së që integriteti i procesit zgjedhor me postë, është i lëndur. Dhe është i vërtetuar që është i lëndur. Tash në procesin e asaj që po mendohet për herë të parë KQZ-ja po vendos me i thirr. E kemi rastin e Istogut. Pasi që PZAP-ja , e kemi një vendim i cili ka thirr votuesit e regjistruar për zgjedhjet në Istog 60 nga Austria prej tyre 56 janë numra nënregjistruar. Janë lajmëruar dy gjermanofolës që s'kan marr pjesë, një është lajmëruar edhe ka thanë jam regjistruar po skam votuar në rëndin e dytë. I kemi nga Mali i Zi, po ashtu pra janë procese të cilët kur janë konfirmuar d.m.th., janë njerëzit që ju ka ndjek identiteti ka votuar dikush për ta. Një është prej Sllovenie dhe konform këtij vendimi KQZ-ja për kashtje mund të merret edhe jonë procesverbalet dhe inqizimet kanë marr qëndrim që në raundin tjetër të gjithë aplikuesit kontaktohen, pra nuk është hera e parë dhe ka shkuar një proces që ska pas kurfar problemi pse tash po del problem nuk e kam të qartë për verifikim as kush nuk po e nal.

Por t'i kthehem ligjit saktë: e drejta me ligj është me votuar vetëm me faks edhe me postë. Se kemi as email as raundin tjetër se na po kthehem tash që e kemi lanë që edhe për shkak të situatës që kushton shumë e ka antarë familjar që nuk dinë me hap email, që të hapet email për familje e tash po bjen të procesi. Në këtë e shikojmë edhe këta vëzhgues që janë edhe mediat thonë jo valla dikush në Kosovë ose njëri nga vendvotimet ka insistuar një person dy herë votuesin. Atëherë cili është procesi kur ti e ke lanë hapur një familje komplet nëse nuk e verifikon një njeri ti plotëson ato fletëvotime. Integriteti është i dobësuar, gjithçka cka është mëndur dje është që të forcohet procesi i votimit të integritetit në proceset të votimit. Nuk e kam të qartë pse dikuj i pengon që ajo le të bahet, nuk është që është keqinterpretuar në media, jo e thërret njëherë edhe ajo ka me eliminuar. Jo more janë proceduar, thirret edhe herën tjetër edhe vendoset. Po shembujt nuk janë të tillë që të lejë lehtë. Janë vendime të cilat janë anuluar zgjedhjet për to . Andaj të shohim dhe ti analizojmë secilën pikë nuk ka problem.

**Sami Kurteshi:** Faleminderit zonja kryesuse. Ne kemi marr këtë vendim dje që ka qenë shqetësues për njerëzit spo i përmendi edhe në grupin e atyre që janë shqetësuar, andaj aj nuk është një grup monolit, nuk janë krejt njëjtte ka edhe prej tyre që janë sinqerisht të shqetësuar, shumica e mërgimtarëve. Ka një grup që vërtet janë shqetësuar se ka mundësi me këto dokumente ju pamundësohet keqpërdorimi i votës edhe ka një grup tjetër që ne në gjuhën shqipe, i thomë Zot bone llug. Edhe aj grup, është aty. Çështja e parë është se në piken 3 të vendimit djeshëm, të kontaktohen të gjithë aplikuesit që teknikisht do të jetë krejtësisht e pamundur, dhe e dyta, a ka ndonjë bazë ligjore dhe prandaj ne kemi këto dokumente që njerëzit që nuk lajmërohen, të ju refuzohet vota. Ne e kemi këtë udhëzim administrativ, por unë mendoj se kemi bërë përpjekje t'i nxjerrim ato elemente...

E kemi një çështje, për të cilën nuk pajtohem: a duhet apo jo të kontaktohen të gjithë aplikuesit me telefon, apo duhet të verifikohen vetëm ata aplikues që bazuar në këtë udhëzim administrativ, konsiderohen nga Sekretariati pas verifikimit të gjithë dokumenteve se, janë raste jo të rregullta, të dyshimta...

**Valdete Daka:** Faleminderit. Atëherë, unë kisha filluar me i lexuar nenet nëse pajtoheni.

**Eshref Vishi:** Kam një propozim pak më ndryshe, unë mendoj se vendimi i djeshëm duhet të kuptohet si vendim i karakterit teknik procedural dhe as sesi vendim politikë, i cili ka për qëllim sigurimin e procesit të votimit dhe keqpërdorimeve eventuale të procesit të votimit dhe të votës. Ne e kemi diskutuar në këshillin për çështje ligjore udhëzimin dhe udhëzimi administrativ është mbi bazën e përputhjes e vendimit të djeshëm dhe unë mendoj që nuk ka nevojë të shkohet nen për nen por vetëm tek neni 3.4 i cili i ka 2 propozime, propozimin e këshillit dhe propozimin e anëtarit të KKZ-ës. Për të gjitha pikat jemi pajtuar kështu që unë mendoj që nuk ka nevojë të merret shumë kohë në sqarimit nen për nen...

**Valdete Daka:** Neni 1, janë dispozitat e përgjithshme ky udhëzime administrativ a për qëllim që të rregulloj hapat për gjatë procesit të verifikimit të aplikacioneve për periudhën e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës dhe do të shërbej si dokument i cili do të përdoret nga sekretariati i KQZ-ës, gjatë procesit të verifikimit të aplikacioneve jashtë Kosovës, është pra qëllimi është despozit e përgjithshme. Ndërsa neni 2, është aplikimi përmes adresës elektronike, prej një adrese elektronike aplikuesi mundet të aplikojë për vete dhe për rrethin e ngushtë familjar, paragrafi 2 thotë nëse prej një adrese elektronike

dërgohen aplikacione për regjistrim të cilat përmbajnë me shumë se dy mbiemra të ndryshëm, KQZ-ja do ti kthej njoftimin e email-it që i ka dërguar këto aplikacione për regjistrim, ku njoftimi do të përmbajë tekstin se aplikacionet për regjistrim nuk do të procedohen duke e dhen shpjegimin se aplikacionet për regjistrim duhet të dërgohen personalisht dhe për rrethin e ngushtë familjar.

Pra, këto pika nuk kanë qenë diskutabile dhe unë i qes në votim, nenin 1 dhe 2. Kush është për? Atëherë vazhdojmë me nenin 3 është verifikimi i aplikacioneve për regjistrim paragrafi 1, i cili thotë sekretariati i KQZ-ës do të bej verifikimin e dokumentacionit për të gjitha aplikacionet për regjistrim jashtë Kosovës, paragrafi 2 thotë verifikimi dokumentacionit për të gjitha aplikacionet do te behet duke ju referuar rregullës zgjedhore 03/2013 te nenit 3.1, 3.2, 3.3 dhe 7.2 të kriterëve zotësisë juridike dhe vendimit së KQZ-ës 42/2020 te datës 11 janar 2021, paragrafi 3 thotë në formularin e aplikimit për regjistrim përveç të dhënave të tjera aplikuësi duhet të shënojë edhe numrin e ti të telefonit. Paragrafi 4 thotë që sekretariati do të verifikojë procesin e aplikimit për regjistrim duke i kontaktuar të gjithë aplikuesit përmes telefonit, këtu pra është ajo dilema disa prej anëtareve. Unë e vendosi ne votim kështu siç është. Kush është për këtë propozim? Sepse është propozim i këshillit për çështje ligjore, pastaj e vendosim edhe propozimin e anëtarit tjetër dhe ajo është që Sekretariati i KQZ-ës do të verifikojë procesin e aplikimit për regjistrim duke kontaktuar te gjitha rastet që gjenerohen dhe konsiderohen nga SKQZ-ja si te dyshimta dhe jo të rregullta sipas kuptimit të pikave, pikave 3.1, 3.2 dhe 3.3 .

Atëherë unë e vendosi fillimisht në votim propozimin e Këshillit për çështje Ligjore. Pra, kush është që sekretariati të ti verifikojë procesin e aplikimit për regjistrimi duke i kontaktuar të gjithë aplikuesit përmes telefonit? Kush është për këtë propozim? Me 7 vota për, kemi 2 vota kundër, dhe 2 abstenime, pra aprovohet propozimi i Këshillit për çështje Ligjore. Mbetet që të verifikohen të gjitha aplikuesit përmes telefonit.

Pikat e tjera, tha zonja Daka, janë kontaktimi i aplikuesve përmes telefonit do të ndahen në 3 faza, thirrja e parë realizohet në orarin e punës sipas kohës lokale në Kosovë, thirrja e dytë realizohet dhe do te behën hetime tjera gjatë orarit te rregullt të punës sipas kohës lokale të shtetit të vendbanimit ku gjendet aplikuesi i shënuar në aplikacion, dhe nëse aplikuesi nuk e hap telefonin as sipas pikës B, do të behët tentimi edhe pas orarit të rregullt të punës sipas kohës lokale të shtetit të vendbanimit ku gjendet aplikuesi i shënuar në aplikacion, neni 4 thotë Sekretariati i KQZ-ës do ti dorëzoj raportin më përmbledhje të rastit më aplikacione të dyshimta dhe të pa konfirmuar dhe rekomandim për vendimmarrje dhe nen 2

në rastet e dështimit dhe verifikimit përmes telefonit si dhe në rastet që nuk konfirmohet aplikimi, sekretariati i rekomandon KQZ-ës rastet për vendim marrje. Neni 5, thotë që KQZ-ja do të njoftojë prokurorinë e shtetit të Republikës së Kosovës për rastet e dyshimta, për mashtrim të organizuar. Kush është për nenin 4 dhe 5. Neni 4 dhe 5 aprovohen në tersi dhe neni 6 është se ky udhëzim administrativ hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit e që është dita e sotme. Këtë udhëzim në tersi unë e vendosi në votim. Kush është që të aprovohet ky udhëzim si i tillë?

Anëtarët e KQZ-së, me 8 vota për, 2 vota kundër, dhe 1 votë abstenim, aprovuan këtë udhëzim i cili, menjëherë do të publikohet në ëeb-faqe.

### **3.Këshilli për Buxhet dhe Financa**

#### **Shqyrtimi i planit të prokurimit për vitin 2021:**

**Sami Hamiti:** Faleminderit, Kryetare. Kërkojë falje në kuptimin edhe për anëtarët e Këshillit për Buxhet por koha ishte e limituar, do të mundohem të i japi sqarimet e mia për këtë plan të prokurimit, plani i prokurimit është i ndarë në dy pjesë, pjesa e parë ka të bëjë me zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës dhe procedurat të cilat fillojnë nga nesër, fatmirësisht qeveria në detyrë e ka aprovuar buxhetin në afat rekord e ka dorëzuar sipas kërkesave që i ka pasur KQZ-ja, dhe menjëherë pas kësaj është bërë edhe plani i prokurimit për operacionet zgjedhore. Nëse i shihni të gjithë anëtarët e KQZ-ës , e shihni pjesën e parë të furnizimeve pikërisht shumica e këtyre ndërlidhen me ato dokumente të cilat i votuam pak më herët, me përjashtime të vogla e kemi edhe dy, një është sotveri i QNR-ës që është në pjesën e saj që e merr një shumë dhe që pa të nuk mundet të behët përditësimi i shënimeve dhe rezultateve në QNR, kjo është pjesa e cila lidhet drejtë për drejtë me furnizimet që lidhet me zgjedhjet e jashtë zakonshme për Kuvendin e Kosovës , në pjesën e dytë janë pjesa e kontratës për furnizim që ndërlidhen me zgjedhjet lokale dhe furnizimet vjetore.

Tani, për të qenë me të saktë, ju kisha lutur që ta shihni pjesën e parë që lidhet me prokurimet apo furnizimet që lidhen me zgjedhjet e parakohshme sepse pjesën tjetër mund ta shohim dhe të e rishikojmë edhe në raste tjera, po flasë krejt për urgjencën që ndërlidhet menjëherë me procedurat që duhet të fillojnë që nga nesër për furnizime. Unë konsideroj që plani është konform planit operacional dhe kërkesat



të cilat vinë nga këshillat dhe pjesa nga sekretariati për furnizime edhe me pjesën sotverit, dhe pjesën e një makine që e kanë pasur për pastrim. Unë e pash pak të elementet i ngrohëseve që ishte një numër i madh, por kam marrur arsyetimin menjëherë që kemi probleme në komunën e Kamenicës që 7 qendra të votimit janë mbyllur shkollat dhe duhet të hapen nga ne, dhe duhet të ketë një furnizim, ngrohëse për qendrat në vendvotime edhe ndërlidhet me objektet të cilat nuk janë objekte publike, ne këtë rast për shkollat që janë në Kamenicë. Në parim unë e kam shikuar dhe i përmban të gjitha kriteret e një planit të prokurimit dhe është në bazë të kërkesave të planit operacional dhe njësisive kërkuese që i kanë bërë në buxhetin të cilin e kanë aprovuar.

**Alim Rama:** Pasi që nuk kemi pasur kohë më e diskutuar në këshill, unë kam vetëm një pyetje për sekretariatit: pse duhet laptopat me qenë në planë të prokurimit të zgjedhjeve edhe një projektor sepse paisjet që janë që planifikohet të jenë ne plan të rregullt të punës duhet me u ble me prokurim të zakonshëm dhe kisha pasur një kërkesë për sekretariatit për shkaqe të afateve të shkurta siç janë, të gjitha prokurimet që behën përmes kontratave specifike të monitorohet nga njësitet tjera dhe sa me shumë persona dhe ekzekutimi dhe negocimi i raporteve të diskutohet në këshill apo në KQZ që të kemi transparencë me të madhe që kontratat të jenë sa me të ndershme. Faleminderit.

**Burim Ahmetaj:** Vetëm desha që fillimisht një plotësim të Z. Hamitit, plani është i ndarë në dy kategori, e para është furnizimet për Zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës dhe furnizimi për zgjedhjet lokale dhe pjesa e dytë është për shërbime. Pjesa e shërbimeve është për Zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës është ne faqen e 3-të që ndërlidhet vetëm më shërbimet që të cilat janë vetëm për Kuvendin e Kosovës dhe pjesa tjetër është shërbimet për zgjedhje lokale, sa i përket pyetjes së Z. Rama ka të bej me operacione për zyrën e partive politike sepse hapësira dhe objekti nuk na premtion funksionalitet dhe kemi konsideruar që do të na duhet që një pjesë të stafit të zyrës ta transferojmë në objektin, ne oborrin apo barakat, në objektin të cilin e kemi marrur nga ministria që është praktikisht në objektin e rilindjes dhe për shkaqe të funksionalitetit do të na duhet të operojmë edhe nga distanca dhe pajisjet që i kemi ne dispozicion nuk na premtojnë që do të mundemi të i përfundojmë këto operacione. Pra edhe arsyetimi nga zyra ka qenë se janë të domosdoshme dhe do të mundemi të i marrim në një kohë me të shpejt. Do me than janë për qëllime të sekretariatit qe konkretisht tani me ju nevojiten zyrës. Faleminderit.

**Valdete Daka:** Nëse nuk kemi diçka tjetër, unë e vendosi në votim. Kush është për këtë planë prokurimit? Faleminderit, njëkohësisht i njoftoj mediat të zëdhënësi do të ketë një konferencë për media lidhur më përfundimin e afatit për koalicione pas pak minutash, siç e dini përfundon afati.

**Të ndryshme!**